



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0103

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Vedat Poterqoi Referues dhe Isa Hasani-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Diamanti Sh.P.K.” kundër Vendimin për dhënien të kontratës ltë Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrjetit te ujësjellësit ne Dumnice Maxhunaj Prelluzhe ritenderim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-12455-5-2-1", me 17/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Diamanti” Sh.P.K.”e datës 06/02/2024 me nr. protkollit 2024/103 , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrjetit te ujësjellësit ne Dumnicë Maxhunaj Prelluzhe ritenderim” Nr. të prokurimit: "VU644-23-12455-5-2-1", iniciuar nga Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK),
2. Anullohet aktiviteti i prokurimit “Zgjerimi i rrjetit te ujësjellësit ne Dumnicë Maxhunaj Prelluzhe ritenderim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-12455-5-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komuna e Vushtrrisë në cilësinë të tërësi, kurse AK ka të drejtë ta ri-tenderoj.
3. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore të ankuesit (me të dhëna si në paragrafin paraprak të këtij vendimi, ankuesit kanë të drejtë të ushtrojnë kërkesë për kthimin e mjeteve, në afatin prej 60/gjashtëdhjetë ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet kalojnë në Buxhetin e Kosovës, sikurse parashihet me paragrafin 6 të nenit 31 të Rregullores për punën e Organit Shqyrtues të Prokurimit, lidhur me nenin 118 të LPP.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 10.11.2023, Komuna e Vushtrrisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues [AK] ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Dumnice Maxhunaj Prelluzhe ritenderim” me nr. të prokurimit: "VU644-23-12455-5-2-1". Me 23.01.2024, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka shpërblyer me kontratë GOE “Kuota,Sh.P.K.; Viante Konstruksion; Kushtrimi Nm Sh.P.K; Company Murseli Sh.P.K”.

Me 26.01.2024, OE “Diamanti Sh.P.K.” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 29.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 06.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Diamanti Sh.P.K.” e cila është evidentuar me nr. protokolli 103/24 lidhur me aktivitetin e cituar si më sipër.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 398,111.84 €.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së, duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Diamanti Sh.P.K.” janë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) ka vepruar në mënyrë të kundërshtueshme me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP). Arsyeja e eliminimit të tyre për mosofrimin e listës së punëtorëve është, sipas ankuesit, e pa bazuar, pasi ata thonë se kanë ofruar listën e punëtorëve duke përfshirë edhe stafin profesional.

OE ankues ka ngritur pretendime kundër GOE të rekomanduar për kontratë, argumentuar se GOE i përzgjedhur është i papërgjegjshëm për disa çështje të specifikuar. Në veçanti, ankuesi/ankuesja vëren se GOE nuk ka paraqitur dëshmi për një pikë të caktuar të kërkuar në dosjen e tenderit, që lidhet me krijimin e një grupi OE, sipas pikës 11.1 (c). Kjo pikë kërkon një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit, duke autorizuar partnerin kryesor për të vepruar në emër të tyre. Megjithatë, GOE e përzgjedhur për kontratë nuk e ka autorizuar partnerin kryesor, siç kërkohej në dosjen e tenderit, por ka autorizuar një OE të quajtur "KUOTA Sh.P.K". Në marrëveshjen e konzorciumit, në Nenet 2 dhe 5, është caktuar që kompania udhëheqëse "Viante Konstrukcion Sh.P.K" është autorizuar për të firmosur të gjitha dokumentet lidhur me tenderin dhe kontratën. Megjithatë, në deklaratën e përbashkët për nënshkrimin e dokumentacionit, GOE e përzgjedhur ka autorizuar OE "KUOTA Sh.P.K", duke shkelur kërkesën e caktuar në marrëveshjen e konzorciumit dhe rregulloren për prokurim publik të përcaktuar në Nenin 26 pika C, që kërkon autorizimin e partnerit udhëheqës për të vepruar në emër të grupit. Partneri udhëheqës nuk është autorizuar në këtë rast. Gjithashtu, në faqen e dytë të marrëveshjes së konzorciumit, shënohet se tenderi është shpallur nga "KOMUNA GLOGOC". OE ankues thekson po ashtu se GOE e rekomanduar për kontratë ka prezantuar z. V.R., si një staf profesional me titullin "Bachelor i emergjencave". Për të qartësuar, z. V.R. është një punëtor i kompanisë Limit Project dhe nuk ka dijeni për këtë projekt. Prandaj, ankuesi/ankuesja njofton se dokumentacioni për z. V.R. është përdorur pa dijeninë e tij. Kjo informacion është konfirmuar nëpërmjet një bisede telefonike me z. Visar Ramadani, dhe ky fakt mund të verifikohet edhe duke kontaktuar atë vetë.

Me tej Ankuesi, argumenton se OE e rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e dytë të Dosjes Teknike, në të cilën kërkohej një "Plan Dinamik Kalendarik" për fillimin dhe përfundimin e kontratës brenda 30 ditëve. Megjithëse kjo kërkesë ishte prezantuar, OE e rekomanduar ka paraqitur një plan dinamik me një afat prej 101 ditësh. Ankuesit kishin kërkuar sqarime për këtë çështje para se ofertat të hapeshin dhe Autoriteti Kontraktues (AK) kishte argumentuar se afati i 30 ditëve ishte i mjaftueshëm për të përfunduar punët. Ankuesi thekson se OE e rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e katërt të dosjes së tenderit, e cila kërkonte që OE të ishte e certifikuar me Certifikatat ISO 9001 për Menaxhimin e Cilësisë dhe ISO 14001 për Menaxhimin e Mjedisit. Kjo kërkesë është specifikuar në Nenin 26.6 të Rregullores Nr. 01/2022 për Prokurim Publik. Prandaj, OE e rekomanduar nuk ka paraqitur këto certifikata për të gjithë anëtarët e grupit të tyre.

OE ankues thekson po ashtu se sipas tij për dy kompanitë, "Kushtrimi Nm Sh.P.K" dhe "Company Murseli" Sh.P.K, numri fiskal i certifikatave të TVSH-së nuk përputhet me numrin

fiskal të Certifikatës së Biznesit. OE ankues vë në dukje se OE "VIANTE SH.P.K" në deklaratën nën betim nuk ka paraqitur emrin e plotë zyrtar, duke përdorur vetëm emrin "Viante Sh.p.k", ndërsa në certifikatën e biznesit emri i plotë është "Viante Konstruksion Sh.P.K".OE ankues vë në pah se GOE e rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën e DT-së për të pasur të paktën dy saldues të certifikuar. Në vend të kësaj, OE e rekomanduar ka prezantuar disa certifikata për pjesëmarrje në trajnime për saldues të hekurit, por këto certifikata nuk kanë datë të skadimit (vlefshmërisë) dhe tregojnë vetëm se personat kanë ndjekur trajnimin, jo që ata janë saldues të certifikuar siç kërkohej në dosjen e tenderit.

OE ankues pretendon se GOE e rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur edhe kërkesën e DT-së për të pasur dy ujëinstalues të certifikuar. OE ankues pretendon se GOE e rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesën për një inxhinier të diplomuar të makinerisë, pasi CV-ja e personit në fjalë nuk është e nënshkruar ashtu siç ishte kërkuar në dosjen e tenderit. OE ankues pretendon se GOE e rekomanduar për kontratë nuk ka prezantuar listën e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit sipas kërkesës së Aneksit 7 të dosjes së tenderit. OE ankues pretendon se GOE e rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kërkesat e Aneksit 8 të dosjes së tenderit. Për shembull, GOE nuk ka prezantuar libra të qarkullimit për disa pajisje të specifikuara dhe nuk ka prezantuar dëshmi për disa pajisje të tjera të nevojshme për kontratën e propozuar. OE ankues pretendon se GOE e rekomanduar për kontratë ka ofruar gjithashtu edhe çmime manipulative për disa pozicione dhe ka bërë paralogari të pavend për pozicionet e mobilizimit. Çmimet e propozuara për pozicionet specifike, si Pozicioni 5, 5.1 dhe 5.36 deri te Pozicioni 6.15, janë identifikuar si jashtë normave të pranueshme për tenderin në fjalë. OE ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues (AK) ka favorizuar GOE-në e rekomanduar për kontratë duke e shpallur atë fituese, megjithëse nuk ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Ankuesit kundërshtuan vendimin e AK-së, por kërkesa e tyre për rishqyrtim u refuzua me argumentin se nuk ishin pale me interes. Ata argumentojnë se AK-ja ka manipuluar vlerësimin e ofertave dhe nuk ka kërkuar vazhdimin e validitetit të ofertave, duke rezultuar në pamundësi për të përcaktuar një fitues të vlefshëm të tenderit.

OE "Diamanti Sh.P.K." konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke kërkuar rishqyrtim të kësaj duke vendosur që të aprovohet ankesa e tij/saj bazuar kurse lënda të kthehet për rivlerësim dhe anulohet njoftimi dhe vendimi i AK-së për dhënien e kontratës, për të vazhduar me vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave sipas dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të specifikuara të dosjes së tenderit. OE "Diamanti Sh.P.K." argumenton se ata kanë plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe do duhej të shpallen fitues të tenderit në fjalë.

Përgjigjja e Autortetit Kontraktues në kërkesën për Rishqyrtim:

Me datën 26.01.2024, kemi marrë kërkesën për rishqyrtim nga OE Ankues, me pretendimet se është shkelur dispozita si Neni 1, Neni 7, Neni 56.3, Neni 59, Neni 60, Neni 62, Neni 69, Neni 72 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), si dhe Neni 44.5 i Rregullores Nr. 001/2022 për

Prokurim Publik. Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe nenvë të theksuar, konstatojmë se asnjëra nga këto pretendime nuk qëndrojnë. Fillimisht, si OE, nuk keni shprehur interes material sipas nenit 4 paragrafi 1.26 të LPP-së, pasi nuk keni ngritur pretendim lidhur me përshtatshmërinë tuaj. Kjo tregon se jeni pajtuar me letrën standarde të eliminimit të ngritur në sistem nga ana jonë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues për këtë Aktivitet të Prokurimit. Kjo gjithashtu sugjeron se jeni OE i papërgjegjshëm dhe pa interes juridiko-material. Kërkesa e OE ankues për rishqyrtim gjithashtu nuk është plotësuar ose formalizuar sipas dhe në përputhje me LPP-në dhe Rregulloren Nr. 001/2022 për Prokurim Publik. Duke marrë për bazë se ju, në cilësinë e OE, nuk keni interes material në këtë aktivitet të prokurimit, pretendimet e OE ankues janë refuzuar në plotësi. Këto pretendime nuk janë trajtuar nga AK për faktin se janë të paqëndrueshme dhe nuk kanë bazë ligjore. Deklarojmë se komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave në mënyrë të argumentuar dhe të drejtë, duke trajtuar të gjithë OE-t pjesëmarrës në mënyrë të barabartë dhe duke vlerësuar me kujdes dokumentacionin e dorëzuar në përmbushjen e secilës kërkesë dhe kriter sipas dosjes së tenderit, konform legjislacionit në fuqi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14/02/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 103/2024, ndërsa me datë 27/02/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me rekomandimet si në vijim:

- a) Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe rekomandon që të anulohet Aktiviteti i Prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues Pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit cituar: Pas pranimit të Ekspertizës dhe analizimit të pretendimeve dhe të gjeturave të konstatuara nga ana e ESH pajtohem që lënda të Anulohet dhe pajtohem me ESH për këtë AP. Ndërsa OE deklaroi se Nuk Pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues cituar “nuk pajtohem me mendimin e ekspertit sepse ne e kemi ofruar listën e punëtorëve duke përfshirë edhe stafin profesional të cilët mund të thirren për zbatimin e këtij projekti ashtu siq është kërkuar në dosje të tenderit tek pika 2, andaj ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe është dashur të shpallemi OE i përgjegjshëm duke na rekomanduar për kontratë, nëse AK-ja ka pasë paqartësi ka mundur të kërkojë sqarime shtesë në bazë të nenit 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimet e OE “Diamanti Sh.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/103 ka vlerësuar shkurtimisht si në vijim :

1. OE ankues është eliminuar për shkak të mosdorëzimit të listës së punëtorëve teknik të nënshkruar dhe vulosur, e cila ishte kërkuar në dosjen e tenderit. Eksperti ka konstatuar se ky veprim i eliminimit është në përputhje me kërkesat e specifikuar në dosjen e tenderit dhe

- është i arsyeshëm dhe i bazuar në Ligjin për Prokurim Publik, sepse ankuesi nuk ka paraqitur një listë të tillë ne ofertëne tij/saj.
2. OE të propozuar ka përdorur një marrëveshje për bashkëpunim-konzorciumi, por struktura e marrëveshjes nuk përputhet plotësisht me kërkesat e rregullores së prokurimit publik. Lidhur me këtë pretendim, eksperti ka konstatuar se kjo dallim mund të jetë një gabim i vogël që nuk ndikon në çështjen thelbësore të marrëveshjes së konzorciumit. Për shkak se në marrëveshje është specifikuar emërtimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe është dhënë numri i prokurimit, kjo pike ankimore konsiderohet e pabazuar.
 3. Për inxhinierin e emergjencave, është ofruar një kontratë pune për projektin nga një anëtar i konzorciumit, duke përputhur kërkesat e dosjes së tenderit. Kjo marrëveshje përmban të dhënat si emërtimin e Aktivitetit të Prokurimit, numrin e prokurimit, Autoritetin Kontraktues, datën, si dhe nënshkrimet e palëve dhe vulën e kompanisë. Duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit është lejuar ofrimi i marrëveshjeve mbi angazhim në këtë projekt, dhe një marrëveshje e tillë është ofruar, pretendimi ankimor i OE ankues nuk ka bazë.
 4. Për kërkesën për një plan dinamik, ofruesi i rekomanduar ka paraqitur një plan që nuk përputhet me kërkesën specifike të dosjes së tenderit. Eksperti Shqyrtues vlerëson se sipas Nenit 38, pika 4e të Rregullores për Prokurim Publik, sqarimet janë pjesë e vlerësimit. Prandaj, periudha 30-ditore për implementim është kërkesë e dosjes së tenderit, dhe në këtë rast, oferta që është ofruar për planin dinamik 101 ditë nuk përputhet me kërkesën e dosjes së tenderit. Rrjedhimisht, pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i qëndrueshëm. Certifikatat ISO janë paraqitur vetëm nga një anëtar i konzorciumit, duke mos u përputhur me kërkesat e rregullores së prokurimit publik. GOE i propozuar për kontratë ka ofruar Certifikata ISO vetëm nga anëtari i konzorciumit "Viante Konstruksion Sh.P.K", dhe jo nga të gjithë anëtarët e konzorciumit ashtu siç është e përcaktuar në Nenin 26.6 të Rregullores për Prokurim Publik. Rrjedhimisht, pretendimi i OE ankues është i bazuar.
 5. Numrat identifikues të anëtarëve të konzorciumit nuk përputhen plotësisht me numrat fiskalë në certifikatën e TVSH-së, por kjo sipas ekspertit shqyrtues nuk është arsye për të cilësuar si OE si të pa përgjegjshëm. Eksperti argumenton se OE janë aktiv në ARBK dhe përcaktimi i numrave identifikues dhe numrit fiskal në certifikatën e TVSH-së është çështje e rregullimit të brendshëm të ARBK-së. Rrjedhimisht, pretendimi i OE ankues për mos përputhjen e numrave identifikues me numrat fiskalë në certifikatën e TVSH-së nuk është i qëndrueshëm.
 6. Eksperti Shqyrtues sqaron se pretendimi ankimor është i pa bazuar për faktin se deklarata nen Betim e OE Viante Konstruksion përmban vulën e cila e ka emërtimin e plotë të kompanisë dhe nënshkrimin, dhe pjesa ku OE ka shkruar emrin e vetëm Viante Sh.P.K nuk paraqet ndonjë mos përmbushje të kërkesës së dosjes së tenderit.
 7. Për kërkesën për saldues dhe dëshmitë dokumentare, ofruesi i rekomanduar ka paraqitur dokumente që përputhen me disa kërkesa, por jo të gjitha duke e cilësuar si pjesërisht të bazuar.
 8. Lista e kontratave të realizuara nga ofruesi i rekomanduar për kontratë nuk është identike me formatin e kërkuar në Aneksin 7 të dosjes së tenderit. Megjithatë, është konstatuar se mosplotësimi identik i tabelës në Aneksin 7 nuk mund të konsiderohet si një arsye për të cilën të rekomanduarit për kontratë duhet të konsiderohen si të papërgjegjshëm. Kjo vlerësim bazohet në faktin se ofruesi i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një tabelë me përshkrimin e kontratave të realizuara në tre vitet e fundit.
 9. Në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues nuk ka trajtuar fare pretendimin lidhur me kërkesën për vazhdim të validitetit të ofertave në mënyrën e duhur, , siç parashihet në nenin 30.4 të Rregullores për prokurim publik, të cilat tashmë janë të skaduara, andaj pretendimi i OE ankues në këtë pikë është i bazuar.”

Pas analizimit të plotë të pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesë dhe Aktivitetit të Prokurimit, Eksperti Shqyrtues arrin në përfundimin se Autoriteti Kontraktues nuk ka kryer Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas Nenit 59 të Ligjit për Prokurimin Publik. Ky konkluzion vjen pasi AK ka rekomanduar një Ofertues Ekonomik i cili është i pa përgjegjshëm. Prandaj, eksperti shqyrtues e konsideron ankesën e OE ankues si të pjesërisht të bazuar dhe rekomandon që aktiviteti i prokurimit të anulohet. Propozimi për anulim mbështetet në Nenin 43.5 pikën (b) të Rregullores për Prokurim Publik, ku asnjë prej tenderëve të pranuar nuk konsiderohet i përgjegjshëm.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Diamanti Sh.P.K." argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Diamanti Sh.P.K." janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues, duke vepruar në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional, ka shqyrtuar të gjitha provat e paraqitura në rastin e prezantuar, duke përfshirë parashtrësat dhe dokumentacionin e OE ankuesit si dhe shkresat dhe dokumentacionin nga Autoriteti Kontraktues. Paneli gjithashtu ka analizuar raportin e ekspertit, mendimet e palëve të interesuara lidhur me këtë raport si dhe dokumentacionin tjetër relevant lidhur me aktivitetin e prokurimit. Pas këtij procesi vlerësues, është konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së Tenderit për aktivitetin e "Zgjerimit të rrjetit të ujësjellësit në Dumnice, Maxhunaj, Prelluzhë - ritenderim" me numrin e prokurimit: "VU644-23-12455-5-2-1"

Pas administimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të gjendjes faktike, dhe mbështetur në Ligjin për Prokurimin Publik si ligj material të zbatueshëm, paneli shqyrtues ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik është pjesërisht e bazuar. Disa pretendime të tij janë konsideruar të mbështetura dhe për to paneli iu referua rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, sepse me të drejtë neni 38, pika 4 e të Rregullores për Prokurim Publik, paresheh se sqarimet e dosjes ne fazën paraprake nga AK duhet të jenë pjesë e vlerësimit, prandaj, periudha 30-ditore për implementim (kontestuese nga ankuesi) ishte shëndërruar në kërkesë specifike e dosjes së tenderit dhe në këtë rast, është fakt se OE i rekomanduar ka ofruar planin dinamik 101 ditë, që rrjedhimisht e bënë të pa përgjegjshëm për këtë aktivitet, pa nevojë për specifikuar arsyet tjera, per te cilat paneli ia fali besimin raportit. Në lidhje me OE ankuesin, paneli ka gjetur se është

eliminuar me të drejtë nga ky aktivitet, pasi nuk i ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Për shembull, nuk ka ofruar minimumin e 20 punëtorëve teknikë siç ishte kërkuar, dhe as nuk ka paraqitur listën e punëtorëve teknikë të nënshkruar dhe të vulosur. Paneli sqaron se nëse ankuesi kishte dyshime lidhur me këtë kërkesë, duhej të paraqiste ankesën tek Autoriteti Kontraktues [AK] dhe Organi shqyrtues I prokurimit [OSHP] në fazën paraprake kundër nftotimit për kontaktë. Në mungesë të kësaj, ankuesi mbart përgjegjësi për prezantimin e ofertës së tij në përputhje me të gjitha kërkesat dhe detyrimet e vendosura në Dokumentacionin e Tenderit, pa asnjë përjashtim.

Paneli shqyrtues mori në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Kontraktues (AK), pas pranimit të raportit të eskeptit shqyrtues, e cila pohoj mes tjerash se pajtohet që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi, për shkak të ofertuesve të pa përgjegjshëm. Paneli shqyrtues lidhur me këtë kërkon nga AK të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave tenderuese duke shfaqur një kulturë institucionale sepse si e till sanksionohet me nenin 59.1 lidhur me nenin 24.2 të LPP-së. Në mënyrë që të evitohen prolongimet e panevojshme të aktiviteteve të prokurimit në dëm të interesit publik.

Paneli Shqyrtues bazuar në të lartëcekurat, ka vendosur që aktiviteti i prokurimit me titull “Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Dumnice Maxhunaj Prelluzhe ritenderim” me të dhënat si më sipër, të anulohet në tërësi në mungesë të ofertave të përgjegjshme dhe në kuptim të nenit 43.5 pikën (b) të Rregullores për Prokurim Publik lidhur me nenin 59.4 cituar “..Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit..”.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër në përputhje me nenin 1,6,7, 104, 105, 117 është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - DIAMANTI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: